REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Drejtorati i Gjendjes Civile
Direkcija Civilnog Stanja
Direktorat of Civil Status
Nr/Br/No. 02 Nr. i fq./Br.str./No. pg. 07
Data/Datum/Date 12.01.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/ GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Departamenti Ligjor / Pravni Departman / Legal Department
Nr./Br./No. 06 Nr. i fq./Br.str./No. pg.
Data/Datum/Date 15/01/2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME-MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/ Office of the Secretary General
Nr./Br./No. 43 Nr.fl./Br.str./No.pg. 1
Data/Datum/Date 16.01.2024
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada – Government*
**Ministria e Punëve të Brendshme**
**Ministarstvo Unutrasnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs**

*Departamenti Ligjor – Pravni Departament – Legal Department*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Besim MYRTEZANI<br>Zëvendësues i drejtorit të Departamentit Ligjor në MAPL<br><br>Ferit IDRIZI<br>Kryetar i Komunës së Vushtrrisë | |
| Kopje: | Elbert KRASNIQI<br>Ministër i MAPL-së<br><br>Jeton QELA<br>Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm /MAPL | |
| Përmes: | XHELAL SVEÇLA<br>Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme<br><br>Fahrije TËRNAVA-SHEREMETI<br>Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme | |
| Nga: | Naim SHALA<br>Drejtor i Departamentit Ligjor - Ministria e Punëve të Brendshme | **Datë:12.01.2024** |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sebahate BARDHI<br>Udhëheqëse e Sektorit të Verifikimit /Drejtorati i Gjendjes Civile<br><br>Merita VISOKA<br>Zyrtare DGJC/ARC | |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Lloji i aktit: | ☐ Statut i komunës<br>☒ Rregullore komunale<br>☐ Vendim i Kuvendit të Komunës<br>☐ Akt tjetër i komunës: ____________ | |

I nderuar Kryetar i Komunës,

I nderuar Drejtor,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike, Ligjin Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin në vijim "MPB") ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Emri i aktit: Rregullore Nr. 286/23 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale |
| I miratuar më datë: 28.12..2023 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.01.2024 |
| I dërguar për shqyrtim në MPB më datë: 05.01.2024 |

Ministria e Punëve të Brendshme, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në rregull për aq sa obligoheni me Ligjin Nr.04/L- 003 për Gjendjen Civile të MPB-së për të ju nënshtruar vlerësimit të ligjshmërisë.

**Arsyetim**

Legjislacioni relevant në fuqi që ka për qëllim rregullimin, kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Konkretisht, Rregullore Nr. 286/23 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale rregullon për aq sa obligohemi me Ligjin Nr.04/L- 003 për Gjendjen Civile të MPB-së.

Ministria e Punëve të Brendshme mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrrisë dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 43-29/1
Data 05.01.2024

# Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Izedin Bytyçi, U.d Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI<br>Enis Spahiu, U.d Sekretar i Përgjithshëm në MFPT<br>Fadile Dyla, Sekretare e Përgjithshme në MASHT<br>Xheladin Krasniqi, U.d Sekretar i Përgjithshëm në MKRS<br>Fahrije Tërnava, Sekretare e Përgjithshme në MPB<br>Naim Bradiqi, U.d Sekretar i Përgjithshëm në MSH | |
| Kopje: | Kryetar i Komunës së Vushtrrisë<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Jeton Qela, U.d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Besim Myrtezani, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 05.01.2024<br>Nr. 43-28 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës<br>2. Zyrtari përgjegjëse për hartimin e shkresës përcjellëse | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Gafurr Sllamniku, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Shkresë përcjellëse | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar **Rregulloren Nr. 286/23 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe e nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Rregulloren Nr. 286/23 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale,
I miratuar më datë: 28.12.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.01.2024

VUSHTRRI - VUČITRN
Datë / Datum 28. 12. 2023
04. 01. 2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

# RREGULLORE
# (KKV) NR.09/2023 RREGULLORE PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

Dhjetor, 2023

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika c të Ligjit Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2 dhe nenit 8 pika (a) të Ligjit Nr.03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 19 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë të aktit të Komunës së Vushtrrisë Nr.43-778 i datës 23.10.2023 i nxjerrë nga MAPL me të cilinë janë adresuar rekomandimet e ministrive gjegjëse, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 28 dhjetor 2023 miratoi këtë:

# RREGULLORE
# PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Me këtë rregullore caktohet lartësia e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime publike komunale, nevoja tjera për persona fizikë dhe juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe jetësor në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 2
### Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar, obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë rregullore, si dhe për të gjitha njësitë e komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje.

### Neni 3
### Përkufizimet

1. Çdo herë kur në këtë Rregullore përdoren termat vijuese kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç rasteve kur konteksti ku paraqitet termi i tillë tregon qartë se ka kuptim tjetër:

2. "Taksë" - do të thotë një shumë fikse e cila paguhet për pranimin e një privilegji, leje, dokumenti ose shërbimi profesional. Taksat zbatohen për licenca, leje, dokumente, shërbime të caktuara ose nevoja të tjera për përmbushjen e të cilave nuk ka shumë - ndryshim në masën e përpjekjeve, kohën ose materialin e nevojshëm.
3. "Gjobë" – do të thotë një pagesë e cila duhet të bëhet në rast të shkeljes së një ligji, rregulle ose rregulloreje komunale. Në përgjithësi, gjobat shqiptohen me qëllim të dëmit të një shkeljeje dhe duhet të shqiptohen në përputhje me shumat e përcaktuara në skemat fizike, të cilat zbatohen për shkeljet e legjislacionit komunal.

4. "Tarifa" – ka kuptimin e shumës e cila paguhet për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, për shërbimet profesionale, për pronësinë e automjeteve etj.

5. "Ngarkesë" – ka kuptimin e shumës e cila paguhet në emër të ndërtimit apo rrënimit të objekteve, shfrytëzimin e burimeve natyrore, të hyrat nga qiradhënia dhe nga lejet në trafik.

"Viti fiskal" – do të thotë periudha prej 1 janar deri 31 dhjetor të të njëjtit vit.

"Rregullore Komunale" – ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale.

"Prona Komunale" – nënkupton pronën, duke përfshirë pronën e paluajtshme dhe të luajtshme, të cilat janë ligjërisht në pronësi ose ligjërisht nën administrimin e komunës.

"Llogaria Zyrtare Bankare" – ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 4

**Bartës të obligimeve për shërbimet komunale janë personat fizikë dhe juridikë**

1.1. Personat, të cilët paraqesin kërkesë për certifikata të ndryshme, vërtetime apo deklarata të cilat lëshohen nga drejtoritë komunale;
1.2. Personat juridikë dhe fizikë, të cilët bëjnë procedimin e kërkesave të tyre për pëlqimin e biznesit;
1.3. Personat/subjektet afariste dhe profesionalistët që kërkojnë marrjen e pëlqimit nga drejtoria përkatëse për Pëlqimin për punë në biznes dhe leje tjera specifike;
1.4. Personat/Subjektet afariste që kërkojnë marrjen e lejes për mjete motorike;
1.5. Personat të cilët bartin pronat përmes transaksioneve;
1.6. Personat të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës, me ndërtime dhe pa ndërtime;
1.7. Subjektet apo personat të cilët organizojnë manifestime sportive dhe kulturore;
1.8. Subjekti fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale banesore, banesave kolektive dhe hapësirave afariste;
1.9. Subjektet apo personat tek të cilët kryhet inspektimi i përshkruar në tarifën përkatëse;
1.10. Subjektet, të cilat merren me shfrytëzimin e resurseve natyrore të parapara me tarifën përkatëse;
1.11 Subjektet apo personat, të cilët paraqiten pronarë, mbajtës të shtazëve dhe kafshëve të tjera përkëdhelëse;
1.12. Subjektet apo personat, të cilët kërkojnë nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, shërbime sipas tarifës së përcaktuar;
1.13. Subjektet apo personat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznese dhe parkingje sipas tarifave përkatëse;
1.14 Subjektet apo personat juridikë e fizikë, të cilët kanë pronë apo janë shfrytëzues të pronës e që janë të obliguar të paguajnë tatimin mbi pronën;
1.15 Subjektet apo personat juridikë dhe fizikë duhet t'i nënshtrohen Ligjit të komunikacionit dhe të cilët u përgjigjen edhe ndëshkimeve (gjobave) në trafik;
1.16. Subjektet apo personat, të cilët bëjnë ekspozimin publik të vitrinave reklamuese, apo panove reklamuese, organizimin e lojërave argëtuese të fatit dhe lojërave automatike, si dhe rekuizitave të tjera sportive sipas tarifave përkatëse;
1.17. Personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistike – teknike;
1.18. Personat që paraqesin kërkesë për leje ndërtimore;
1.19. Personat që paraqesin kërkesë për leje përdorimi;
1.20. Subjektet apo personat juridikë dhe fizikë për regjistrim apo riregjistrim të automjeteve;
1.21. Personat që paraqesin kërkesë për leje pune në afarizëm.

**Neni 5**
**Inkasimi i të hyrave**

1. Inkasimi i të hyrave komunale, sipas kësaj rregulloreje, ndonjë urdhëresc administrative, apo ndonjë udhëzimi administrativ, të nxjerrura nga ndonjë institucion tjetër qendror do të bëhet në çdo muaj, në gjashtë muaj apo në fund të vitit, varësisht prej natyrës së tyre dhe ato do të deponohen në buxhetin e komunës.

2. Sipas kësaj rregulloreje, drejtoritë përgjegjëse obligohen që të mbajnë evidencë për pagesat në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

**Neni 6**
**Pagesat**

1. Pagesa për kryerjen e shërbimeve administrative komunale bëhet në monedhën euro (€), e cila është e aplikueshme si mjet pagese monetare në Republikën e Kosovës.
2.Taksat administrative paguhen në shumat e përcaktuara sipas kësaj rregulloreje. Paguesi obligohet t'i paraqesë nëpunësit administrativ dëshmi adekuate se tatimi është paguar.
3.Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat dhe taksat sipas rregullores komunale, në llogaritë përkatëse të komunës, drejtpërsëdrejti në arkën komunale deri në 10 €, ndërsa përmes bankave afariste në shumën mbi 10 €.

**Neni 7**
**Lirimi nga taksat, ngarkesat dhe tarifat**

1. Nga ngarkesat e taksës administrative lirohen grupet e caktuara, si dhe në bazë të subjektit të kërkesës. Varësisht prej llojit të shërbimit administrativ të kërkuar, të cilat janë të specifikuara në drejtoritë përkatëse të komunës.
2.Nga pagesa e çdo takse administrative komunale lirohen:
2.1. Organet lokale, regjionale, qeveritare, të Republikës së Kosovës, si dhe organet e tyre të cilat adresojnë kërkesa zyrtare.
2.2. Institucionet publike në fushat e: fëmijëve parashkollorë, arsimit, shkencës, kulturës, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore, shëndetit, mirëqenies sociale, për kërkesat/aktivitetet e tyre.
2.3. Rastet sociale, personat me nevoja të veçanta dhe personat e verbër.
2.4. Invalidët e luftës, veteranët, viktimat e luftës, si dhe familjet e ngushta të dëshmorëve, të viktimave civile, të të zhdukurve, të UÇK-së dhe të burgosurit politikë.

3. Nga pagesa e taksës administrative gjithashtu lirohen:
3.1 Peticionet, ankesat dhe propozimet drejtuar institucioneve komunale dhe organeve tjera publike;
3.2 Dokumentet dhe veprimet në procedurën e korrigjimit të gabimeve të bëra nga zyrtarët përgjegjës komunal në vendime, dokumente dhe regjistra;
3.3 Dokumentet dhe shërbimet për të cilat lirimi i pagesës është rregulluar me rregulloret ose vendimet komunale të specifikuara për shërbime të caktuara;
3.4 Vërtetimi mbi pranimin e kërkesës apo ankesës.

4. Nëse vendimi apo dokumenti lëshohet pa pagesën e taksës administrative, atëherë zyrtari përgjegjës administrativ, dokumenteve të palës ia bashkëngjit shkresën me bazën ligjore për përjashtim nga pagesa.

## Neni 8

## Lartësia e tarifave dhe taksave komunale

Lartësia e tarifave dhe taksave komunale që do të paguajnë qytetarët, personat fizikë dhe juridikë, në emër të shërbimeve komunale që iu ofrohen, do të caktohen sipas drejtorive përkatëse.

| 1. | **Taksat/tarifat për lëshimin e dokumenteve dhe certifikatave zyrtare në Drejtorinë për Administratë** | |
|---|---|---|
| N/r | Shërbimet (dokumenti) | **Lartësia e taksës në €** |
| 1.1 | Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile për përdorim jashtë vendit, lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil. | 1.00 € |
| 1.2 | Certifikatat dhe dokumentet për përdorim brenda vendit, lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4 dhe lëshohen me afat të pakufizuar vlefshmërie. | 1.00 € |
| 1.3 | Certifikatat që lëshohen nga E-kiosku. | 1.00 € |
| 1.4 | Vendimi për ndërrimin e emrit personal për persona të rritur. | 50.00 € |
| 1.5 | Vendimi për ndërrimin e mbiemrit pas shkurorëzimit (kthimin e mbiemrit të lindjes). | 10.00 € |
| 1.6 | Vendimi për ndërrimin e emrit personal, për persona të mitur. | 10.00€ |
| 1.7 | Vendimi për korrigjimin e të dhënave personale. | 3.00 € |
| 1.8 | Vendimi për anulimin e regjistrimit të faktit të lindjes. | 10.00 € |
| 1.9 | Procedura-Ceremonia e kurorëzimit. | 10.00 € |
| 1.10 | Procedura-Ceremonia e kurorëzimit jashtë orarit të punës, brenda selisë së komunës. | 50.00 € |
| 1.11 | Procedura-Ceremonia e kurorëzimit brenda dhe jashtë orarit te punës, jashtë selisë së komunës. | 150.00€ |
| 1.12 | Aplikimi për fitim ose lirim nga shtetësia. | 10.00 € |

| | | |
|---|---|---|
| 1.13 | Kërkesa për ndërrimin e adresës së vendbanimit. | 5.00 € |
| 1.14 | Certifikatat në rastin e regjistrimit të fëmijës së porsalindur, regjistrimit të faktit të vdekjes dhe në rastin e kurorëzimit. | 1.00 € |
| 1.15 | Dëshmia e vdekjes. | 1.00 € |
| 1.16 | Vërtetim identik me origjinalin (një kopje). | 1.00 € |
| 1.17 | Vërtetime dhe dokumente të ndryshme, që nuk janë përfshirë në rregullore. | 1.00 € |
| 1.18 | Gjetja-sigurimi i dokumenteve në arkivin e drejtorisë. | 2.00€ |
| 1.19 | Dëshmi e qëndrimit në Kosovë. | 5.00€ |
| 2. | **Sipas nenit 63 të Ligjit Nr.04/L-003 Për Gjendjen Civile me gjobë dënohen personat për këto shkelje:** | |
| 2.1 | Prej njëzet (20) Euro kur nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me këtë ligj; | 20 € |
| 2.2 | Prej pesëdhjetë (50) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji; | 50 € |

| | |
|---|---|
| 3. | Nga pagesa në taksë, për shërbimet e kryera nga neni 8, pikat 1.1, 1.2,1.5,1.7,1.8,1.9,1.14, 1.15,1.16, 1.17, 1.18, lirohen kategoritë si më poshtë:<br>a) Familjet e dëshmorëve (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët e dëshmorëve deri në moshën 18-vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);<br>b) Veteranët e luftës (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);<br>c) Invalidët e luftës (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);<br>d) Familjet e viktimave të luftës (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);<br>e) Invalidët civilë të luftës (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);<br>f) Të burgosurit politikë (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18- vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt), pasi që pala të paraqesë dëshminë nga ministria;<br>g) Shfrytëzuesi i ndihmës sociale (prindi, bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, respektivisht 26-vjeçare, nëse janë duke ndjekur shkollimin e rregullt);<br>h) Handikos-i, Sindrom-Down, shurdhmemecët dhe të verbërit;<br>i) Personat e riatdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas riatdhesimit; |

| | |
|---|---|
| | j) Nga pagesa në taksë për shërbimet e kryera nga neni 3, pika 1.2 dhe 1.14, lirohen të gjithë qytetarët të cilët në Regjistrin Qendror Elektronik të Gjendjes Civile kanë adresën e vendbanimit në territorin e Komunës së Vushtrrisë;<br>k) Nga neni 3, pika, 1.1, 1.2 dhe 1.15, lirohen të gjitha rastet kur lëshimi i dokumentit bëhet zyrtarisht për nevoja të gjykatës dhe noterit; |
| 4. | Pagesa për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Vushtrrisë në bazë të UNIREF-it. |

## Neni 9
## Tarifat në sferën e shërbimeve publike

| | | Lartësia e taksës në € |
|---|---|---|
| **1. Tarifa vjetore për parkingje në pronë komunale, para ndërtesave dhe objekteve tjera janë:** | | 100.00 |
| 1.1. | Kamionët, autobusët | 100.00 |
| 1.2. | Vetura, parkimi me veprimtari profitabile (biznes) | 50.00 |
| 1.3. | Kombibusët, tarifa vjetore | 50.00 |
| 1.4. | Veturat | 50.00 |
| 1.5. | Ndalja e veturave për ngarkim-shkarkim, ku ka hapësirë të mjaftueshme | 30.00 |
| 1.6. | Veturat taksi | |
| **2\| Parkingu kohor për 1 orë** | | 0.50 |
| 2.1. | Në parkingjet e KK-së | 0.50 |
| 2.2. | Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona I | 0.30 |
| 2.3. | Në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona II | |
| **3. Shfrytëzimi i trotuareve gjatë ndërtimeve dhe renovimeve të ndryshme, kompensimi ditor** | | 0.50 m² |
| 3.1. | Zona e I | 0.30 m² |
| 3.2. | Zona e II | 0.20 m² |
| 3.3. | Zona e III | |
| **4. Pagesa vjetore për regjistrim të automjeteve** | | 10.00 |
| 4.1. | Për automjetet që peshojnë deri në 3.5 t | 20.00 |
| 4.2. | Për automjetet që peshojnë mbi 3.5 t. | |
| **5. Ekspozimi i pllakateve (panëve) reklamuese - tarifa vjetore për m²** | | 30.00 |
| 5.1. | Zona urbane | 20.00 |
| 5.2. | Zona jashtë urbane | 30 % |
| 5.3. | Pllakatet (panët) reklamuese me ndriçim, paguhen me tarifë të shtuar | 100.00 |
| 5.4. | Vendosja e reklamave elektronike – ekraneve | |
| **6. Shërbime tjera** | | 50.00 |
| 6.1. | Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike në bazë të kërkesave të qytetarëve, për vendosjen e pengesave në rrugë | 50.00 |
| 6.2. | Leje për vendosjen e materialit ndërtimor në hapësirat publike për 24 orë | 50.00 |
| 6.3. | Leje për bllokim të rrugës – shiritit rrugor – trotuarit për 24 orë | 100.00 |
| 6.4 | Licenca për ushtrimin e veprimtarisë - transport i udhëtarëve | 0.50 |
| 6.5 | Vërtetimi i rendit të udhëtimit - operatori transportues paguan taksën | |

| | | |
|---|---|---|
| | për një vit për 1 km. | |
| 6.6 | Leje për hyrje në qytet të automjetit transportues mbi 3.5 t, për 24 orë | 25.00 |
| 6.7 | Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për vendparkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtarë | 50.00 |
| 6.8 | Pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë autoparkingje/vjetore | 50.00 |
| 6.9 | Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore | 50.00 |
| 6.10 | Leje për prerjen e asfaltit në rrugë për metër katror | 50.00 |
| 6.11 | Leje për prerjen e rrugëve dhe trotuareve me kubëza të betonit, për metër katror | 25.00 |
| 6.12 | Leje për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të paasfaltuara, parqeve, etj., për metër katror | 15.00 |
| 7 | **Te objektet e karburantit-gazit, taksa komunale dhe tarifa për densitet llogaritet nga çmimi bazë, varësisht nga lloji i sipërfaqes-hapësirës si vijon(Me sipërfaqe të mbyllur) 100 %** | |
| 8. | Nëse shfrytëzimi i reklamës bëhet më pak se 30 ditë, shtohet vlera për 100 %, kurse nëse pllakati është shumëkrahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm | |
| 9. | Reklamimi i pijeve alkoolike dhe duhanit është i ndaluar | |
| 10. | Nga pagesa për leje për mjete motorike lirohen të gjitha automjetet e emergjencës (ambulanca dhe makinat e zjarrfikësve). | |

### Neni 10

### Tarifat e sferës së ekonomisë, bujqësisë dhe pylltarisë

| **1. Tarifa vjetore** | | **Lartësia e tarifë në €** |
|---|---|---|
| **1.1.** | Certifikatë bujqësore | 1.00 € |
| **1.2.** | Certifikatë për shitjen e produkteve bujqësore | 1.00 € |

### Neni 11

### Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

1. Të gjithë personat fizikë apo juridikë, kompensimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore e bëjnë para marrjes së lejes ndërtimore.
2. Shuma e kompensimit varet nga klasifikimi i tokës përkatëse. Nëse ndërrimi i kërkuar i destinimit ka të bëjë me tokën e:

2.1. Klasës 1 – 4, kompensimi do të jetë 1.00 € për m$^2$;

2.2. Klasës 5 – 6, kompensimi do të jetë 0.75 € për m$^2$;

2.3. Klasës 7 – 8, kompensimi do të jetë 0.50 € për $m^2$.

3. Kompensimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për klasën 1 – 6 bëhet pas konfirmimit nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, se ndërrimi i destinimit është në pajtim me Planin Hapësinor dhe Urban të Komunës.

3.1. Në rastet kur parcela për ndërrim të destinimit gjendet jashtë kufijve të planit hapësinor – urban, kompensimi për ndërrimin e destinimit për klasën 1 – 6 bëhet pas nxjerrjes së vendimit nga Kuvendi i komunës.

3.2. Në rastet kur parcela për ndërrim të destinimit gjendet jashtë kufijve të planit hapësinor – urban, kompensimi për ndërrimin e destinimit për klasën 7 – 8 bëhet pas nxjerrjes së vendimit për ndërrimin e destinimit nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

3.3. Lirohen nga pagesa e taksës komunale për ndërrimin e destinimit të pronës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore të gjithë përfituesit e skemave qeveritare, komunale si dhe granteve nga organizata të tjera.

## Neni 12
## Dhënia në shfrytëzim e tokës bujqësore me qira

1. Propozimin për dhënien e tokës bujqësore me qira e paraqet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes Kryetarit të komunës.

2. Forma e dhënies së tokës ndërtimore në shfrytëzim me qira bëhet konform Ligjit Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Rregullores në fuqi për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme komunale.

## Neni 13
## Ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste/biznesore në territorin e Komunës së Vushtrrisë

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), që ndodhet brenda komunës, paguan taksë vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitete ekonomike të zhvilluara si në vijim:

| | *Veprimtaria* | Lartësia e tarifës në € |
|---|---|---|
| 1 | Metalurgjia e rëndë | 65.000 |
| 2 | Minierat | 25.000 |
| 3 | Gurëthyesit | 4.000 |
| 4 | Ndërmarrja publike – Posta/Telekomi | 1.000 |
| 5 | KEDS | 2.000 |

| | | |
|---|---|---|
| 6 | KESCO | 2.500 |
| 7 | Bankat | 2.500 |
| 8 | Institucionet mikrofinanciare (Kredidhënie) | 500 |
| 9 | Trafo kryesore-shpërndarës të energjisë elektrike | 3.000 |
| 10 | Kompanitë e sigurimeve që merren me sigurimin e automjeteve, pasurisë së personave etj. | 1.000 |
| 11 | Pompat e derivateve në rrugë magjistrale | 2.000 |
| 12 | Pompat e derivateve në zonat urbane | 1.500 |
| 13 | Pompat e derivateve në zonat rurale | 500 |
| 14 | SHPK të tjera | 300 |
| 15 | Prodhimi i lëndëve plastike | 600 |
| 16 | Prodhimi i produkteve tjera kimike | 800 |
| 17 | Veprimtaritë shërbyese veterinare | 200 |
| 18 | Ordinancat shëndetësore | 300 |
| 19 | Ordinancat stomatologjike | 300 |
| 20 | Laboratorët për analiza të ndryshme, specialistike shëndetësore | 300 |
| 21 | Barnatoret | 400 |
| 22 | Kontrollime teknike | 500 |
| 23 | Shpërndarës të internetit dhe TV kabllorë | 1.200 |
| 24 | Përmbaruesit privat | 800 |
| 25 | Avokaturat | 200 |
| 26 | Noteri | 1.000 |
| 27 | Eksploatimi-grumbullimi i rërës për qëllime komerciale | 1.000 |
| 28 | Veprimtaria e çerdheve | 50 |
| 29 | Agjencitë e ndërmjetësimit në transaksionet e pasurisë së patundshme dhe agjencitë tjera | 400 |
| 30 | Veprimtaritë e shtypshkronjave dhe aktiviteteve grafike | 70 |
| 31 | Tregtia e automjeteve të reja | 400 |
| 32 | Tregtia e automjeteve të vjetra dhe autopjesëve të vjetra | 800 |
| 33 | Marketet | 800 |
| 34 | Minimarketet | 100 |
| 35 | Hotelet | 800 |

| | | |
|---|---|---|
| 36 | Motelet | 800 |
| 37 | Klubet e natës/muzikë live | 1.500 |
| 38 | Kazinot (të ndaluara me ligj) | 2.500 |
| 39 | Bastoret/ lojërat e fatit (të ndaluara me ligj) | 1.200 |
| 40 | Restorantet | 100 |
| 41 | Sallat e dasmave | 500 |
| 42 | Bufetë | 50 |
| 43 | Qebaptoret | 50 |
| 44 | Byrektoret | 50 |
| 45 | Ëmbëltoret | 50 |
| 46 | Bukëpjekësit | 50 |
| 47 | Gjellëtoret | 50 |
| 48 | Kafenetë | 100 |
| 49 | Autolarjet | 25 |
| 50 | Argjendarët | 100 |
| 51 | Autoshkollat | 50 |
| 52 | Mbajtja e kurseve të ndryshme profesionale | 50 |
| 53 | Frizer për meshkuj/femra | 50 |
| 54 | Qendrat estetike | 50 |
| 55 | Pishinat | 100 |

## 2. Kategoritë të cilat lirohen nga pagesa

2.1 Çdo biznes në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

2.2 Lirohen për kohë të pacaktuar nga pagesa e taksës komunale të gjitha bizneset ekzistuese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në të gjithë sektorët e prodhimtarisë bujqësore, përveç nëse caktohet/vendoset ndryshe me vendim të Kuvendit/Kryetarit.

2.3 **Lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Vushtrrisë, deri në kohë të pacaktuar, përveç nëse caktohet/vendoset ndryshe me vendim të Kuvendit/Kryetarit, përjashtuar institucionet financiare dhe lojrat e fatit.**

2.4 Të gjitha bizneset që raportojnë në ATK, me pasqyrat financiare (formular) të pagesës së tatimit në qarkullim, e të cilët dorëzohen për atë vit kalendarik me zero qarkullim, lirohen edhe nga taksa komunale për atë vit kalendarik që nuk kanë ushtruar veprimtarinë, duke i sjellë si dëshmi pasqyrat financiare të vërtetuara nga ATK-ja për vitin paraprak.

2.5 Drejtoria Përgjegjëse e Financave bën shpërndarjen e faturave, nga data 1 maj deri më 30 qershor. Të gjitha bizneset të cilat nuk lirohen nga kjo rregullore apo aktet tjera në fuqi, janë të obliguar që brenda vitit të bëjnë pagesën e obligimeve.

**Neni 14**

**Taksat dhe tarifat në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**

14.1. Tarifat administrative për leje administrative rregullohen sipas Nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për ndërtimin dhe Udhëzimit administrativ Nr.02/2018 për taksa administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

14.2. Ngarkesat për dhënien në përdorim të pronës komunale, para se të aplikohet tarifa e ngarkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, në radhë të parë do të vlejë vlera e tregut, e më pas do të aplikohet tarifa si vijon.

14.3. Taksa për leje ndërtimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës të përcaktuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, si dhe pas pëlqimit të marrë nga ministria përkatëse; hyn në fuqi pas kalimit të afateve të përcaktuara me Ligjin për Ndërtimin dhe Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

14.3.1. Për lëshim të lejes së ndërtimit paguhet taksë administrative për kategorin e I-rë në vlerë prej **2.00€ për m²** dhe taksë administrative për kategorin e II-të në vlerë prej **2.92€ për m²**

14.3.2. Në rastin e llogaritjes së lartësisë së taksës për leje ndërtimore për objekte të banimit, aplikuesi do të paguajë në të njëjtën kohë edhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës në vlerë prej **3.50 € për m²** (neto)

14.3.3.Lartësia e kompenzimit për llogaritjen e taksës për leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të është në vlerë prej 0.84€/m²

| | | |
|---|---|---|
| | **Taksat administrative dhe tarifat për leje ndërtimore dhe leje rrënimi** | |
| | Taksa adminsitrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë (parë) | **2.00 €/m²** |
| | Taksa adminsitrative për leje ndërtimore për kategorinë e II-të (dytë) | **2.92 €/m²** |
| | Tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës | **3.50€/m²** |
| | Taksa adminsitrative për leje të rrënimit | **0.84€/ m²** |

14.4. Lartësia e kompensimit për llogaritjen e taksës administrative për $m^2$ të sipërfaqes llogaritet Bruto, ndërsa për tarifën për ndikim nga rritja e densitetit të infrastrukturës për $m^2$ të sipërfaqes llogaritet Neto.

14.5.Llogaritja e taksës administrative nga paragrafi 14.3.1.,behet në sipërfaqe për ($m^2$) bruto te ndërtimit, sipas dokumentacionit ndërtimor-projektit kryesor te prezantuar për te cilin është dhënë miratimi dhe lejohet ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe II-të.

14.5.1. Llogaritja e tarifës nga paragrafi 14.3.2, bëhet në sipërfaqe (m2) neto pa mure të njësive të reja të banimit, e cila përcaktohet me formulën si vijon:

a, $Sn=\sum (S \times k)$, ku:

b. Sn - sipërfaqja neto e banesës'

c. S– sipërfaqja e hapësirës përkatëse ne banese

d. k- koeficienti

14.5.2. Koeficienti "k" për sipërfaqet e ndryshme në banesë ka vlerë të ndryshme, si vijon: te gjitha hapësirat prej hyrjes kryesore në banesë apo në shtëpi individuale të banimit në shërbim të tyre, duke mos llogaritur sipërfaqen që zënë muret, kanë koeficient k=1'

a. ballkonet k = 0,5,

b. loxhat k= 0,75,

c. tarracat e mbuluara k = 0,5,

d . tarracat e pambuluara k : 0,25,

e. depo brenda banesës = 0,5.

14.6. Meqë nuk krijojnë densitet, nga tarifa për ndikimin e densitetit të infrastrukturës lirohen:

a. lokalet afariste,

b. Hapësirat e përbashkëta në ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, si: para hyrjet, ashensorët, shkallët, shkallët kundër zjarrit, korridoret, kthinat teknike, depot, hapësirat për këshillin shtëpiak, bodrumet, garazhet etj;

c. hapësirat ajrore në kuadër të objektit;

d. pasazhet;

e. kulmet e pashfrytëzuara;

f. tarracat në bashkëpronësi dhe para lokaleve dhe

g. kthinat tjera të ngjashme që nuk konsiderohen hapësira për banim.

14.7. Për shndërrimin e objekteve banesore në objekte afariste aplikohet taksë e njëjtë administrative, e cila aplikohet për lëshimin e lejeve të ndërtimeve.

**Neni 15**
**Mënyra dhe afatet e pagesës**

15.1. Pagesa e taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukture e cila tejkalon shumën prej 25.000.00€, mund të bëhet në tri këste, të përshkruara si më poshtë:

a. kësti i pare, pagesa prej 40%,

b. kësti i dytë, pagesa prej 30% dhe

c. kësti i tretë, pagesa prej 30%.

15.1.1 Afati për përmbushjen e obligimit të përcaktuar sipas paragrafit 15.1 të këtij neni, do të jetë dymbëdhjetë (12) muaj.

15.1.2. Fillimi i afatit prej 12 muajsh sipas paragrafit 15.1.1, do të llogaritet dita e marrjes në dorëzim të lejes së ndërtimit.

15.2. Pagesa e taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në infrastrukture sipas kësaj rregulloreje, e cila tejkalon shumën prej 80.000.00€, mund të bëhet në katër këste, të përshkruara si më poshtë:

a. kësti i pare, pagesa prej 30%,
b. kësti i dytë, pagesa prej 30%
c. kësti i tretë, pagesa prej 20% dhe
d. kësti i katërt, pagesa prej 20%

15.2.1. Afati për përmbushjen e obligimit të përcaktuar sipas paragrafit 15.2, do të jetë tetëmbëdhjete (18) muaj.

15.2.2. Fillimi i afatit prej 18 muajsh sipas paragrafit 15.2.1 do të llogaritet dita e marrjes në dorëzim të lejes së ndërtimit.

15.3. Rrjedhja e afatit për pagesën e taksës sipas paragrafit 15.1 dhe 15.2. të kësaj rregulloreje, fillon ditën e pare pas marrjes në dorëzim të vendimit për llogaritjen e taksës përkatëse, dhe nuk mund të jetë më i gjatë se pesë (5) ditë pas marrjes së aktvendimit për taksa.

15.4. Kësti i pare sipas paragrafit 15.1 dhe 15.2 do të paguhet brenda afatit të paraparë sipas paragrafit 15.3. Bashkë me pagesën e këstit të pare, aplikuesi i lejes së ndërtimit është i obliguar që organit kompetent t'ia prezantojë garancinë financiare, me të cilën sigurohen pagesat e késteve të mbetura për pagesë, sipas afateve të përshkruara në paragrafin 15.1 dhe 15.2.

15.5. Vendimi për leje ndërtimi nuk mund të jepet në dorëzim pa provën mbi pagesën e kompensimit të llogaritur e të arritur për pagesë dhe të garancisë financiare.

15.6. Nëse pagesa e kompensimit të llogaritur nuk bëhet brenda afatit të paraparë sipas paragrafit 8 do të pasoj refuzimi i kërkesës për dhënien e lejes së ndërtimit.

15.7. Rishqyrtimi dhe ushtrimi i mjetit juridik kundër Vendimit mbi llogaritjen e taksës sipas kësaj rregullore, nuk e shtyn afatin për pagesë, e as nuk i ndalon veprimet e organit të paraparë në këtë nen të kësaj rregulloreje.

15.8. Për aplikuesit të cilëve iu miratohen kërkesat për leje të ndërtimit, kjo shumë do të jetë pjesë e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, ndërsa aplikuesve të cilëve iu refuzohet kërkesa, kjo takes nuk do të iu kthehet, pasi që organi krijon shpenzime në shqyrtim të aplikacionit.

## Neni 16
## Taksat dhe tarifat në sferën e urbanizmit

| 16.1 | Taksat/tarifat për lëshimin e dokumenteve dhe certifikatave zyrtare në Drejtorinë për Urbanizëm |
|---|---|

| N/r | Shërbimet (dokumenti) | Lartësia e taksës € |
|---|---|---|
| 16.1 | Taksa për çdo kopje të dokumenteve të planifikimit hapësinor të komunës të kërkuara nga pala | 5.00 € |
| 1.21 | Për shfrytëzimin e Palestrës së sporteve lirohen nga pagesa klubet sportive të komunës, që garojnë në ligën e parë dhe Superligën e Kosovës | |
| 1.22 | **Tarifat për subjektet e interesuara që iu mundësohet vendosja e reklamave të tyre**<br><br>Vendosja e reklamave me dimensione për një muaj: | |
| 1.23 | Në qendrën e fushës së basketbollit në parket | 40.00€. |
| 1.24 | Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit | 20.00 €. |
| 1.25 | Në hapësirën e gjashtëmetërshit të fushës së hendbollit -//-2 X 0.60 m | 20.00 €. |
| 1.26 | Në hapësirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit-//-2 X 0.60 m | 20.00 €. |
| ~~1.27~~ | ~~Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit-//-3 X 0.60 m~~ | ~~20.00 €.~~ |
| 1.28 | Në pjesën anësore (lindje dhe perëndim) të pallatit 2 X 0,80 m | 20.00 €. |
| 1.29 | Në pjesët tjera të palestrës, dimensioni 2 X 0.60 m | 10.00 €. |

## 2. Kategoritë të cilat lirohen nga pagesa

**Nga pagesat e përmendura të kësaj rregulloreje, lirohen:**

- klubet sportive publike të Komunës së Vushtrrisë;
- Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së (të Komunës së Vushtrrisë);

- FSK për dy termine në javë, nga një orë pa pagesë për dy termine brenda javës;
- Shoqata "HANDIKOS" për një termin brenda javës;
- Manifestimet dhe tubimet e organizuara nga ana e Komunës së Vushtrrisë;
- SHPKF dhe SSH për organizimin dhe mbajtjen e garave shkollore në nivel komunal, regjional dhe republikan;
- SHPK, bashkësitë fetare;
- Shoqatat dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse, të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë.

### Neni 27
### Tarifat në sferën e inspektimeve

**1. Tarifa lidhur me pranimin teknik të lokaleve mbi plotësimin e kushteve minimale teknike**

| Nr. | **Tarifat për pranim teknik të lokaleve afariste** | **Lartësia e tarifës në €** |
|---|---|---|
| 1.1. | Për lokalet afariste deri në 50 $m^2$ | 40 |
| 1.2. | Për lokalet afariste prej 50.01 $m^2$ deri në 100 $m^2$ | 80 |
| 1.3. | Për lokalet afariste prej 100.01 $m^2$ deri në 300 $m^2$ | 150 |
| 1.4. | Për lokalet afariste 300.01 $m^2$ deri në 600 $m^2$ | 200 |
| 1.5. | Për lokalet afariste 600.01 $m^2$ deri në 1000 $m^2$ | 300 |
| 1.6. | Për lokalet afariste mbi 1000 $m^2$ | 500 |

**2. Tarifa për mallrat me afat të skaduar apo mallrat e dëmtuara, për asgjësim të tyre**

| c) Të gjitha subjektet afariste do të paguajnë tarifën dhe atë: | | |
|---|---|---|
| 2.1. | Mall në peshë prej - 10,00 kg deri në 20,00 kg | 10.00 € |
| 2.2. | Mall në peshë mbi 20,01 kg deri 99,99 kg | 30.00 € |
| 2.3. | Në peshë prej – 100,00 kg deri 999,999 kg | 70.00 € |
| 2.4. | Në peshë prej - 1000 kg deri 10000 kg | 150.00 € |
| 2.5. | Mbi 10000 kg | 300.00 € |

3. Operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve: auto-taxi, operatorët taxi, kombibusët dhe autobusët për pranim të kushteve teknike për çdo automjet të tyre do të paguajnë tarifat:

| | Operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve: auto-taxi, operatorët taxi, kombibusët dhe autobusët për pranim të kushteve teknike për çdo automjet të tyre do të paguajnë tarifat | Lartësia e tarifës në € |
|---|---|---|
| 3.1. | Transportuesit e udhëtarëve – me autobus | 50.00 |
| 3.2. | Operatorët – taxi | 10.00 |
| 3.3. | Auto – taxi | 10.00 |
| 3.4. | Kombibusët | 20.00 |

**Neni 28**
**II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Rregullorja zbatohet nën autoritetin e plotë të komunës dhe nën mbikëqyrjen e drejtorive kompetente.

2. Për të gjitha tarifat dhe ngarkesat e caktuara që nuk janë të parapara me këtë rregullore, do të aplikohen tarifat dhe ngarkesat e caktuara me ligj dhe udhëzime përkatëse.

**Neni 29**
**Dispozita shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

1. Shfuqizohet rregullorja per tarifa dhe ngarkesa komunale, 01/Nr.278/15 të datës 30.12.2015
2. Shfuqizohet rregullorja Nr. 01/Nr.45/20 të datë 27.02.2020, Për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale, 01/Nr.278/15 të datës 30.12.2015.

**Neni 30**
**Zbatimi i rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: drejtoritë kompetentet komunale, që lidhet me sferën e aplikimit të taksave dhe tarifave komunale.

**31**
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë |
| Propozues dhe Hartues: | Znj.Melihate Bashollí-Latifi, kryesuese e kuvendit |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Sekretarisë së kuvendit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Akt - përcjellës |
| Datë: | 27.12.2023 |

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkangjitur Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, e cila është harmonizuar me legjislacionin në fuqi sipas rekomandimeve të dhëna nga ministritë e linjës të proceduara përmes MAPL-së. Komisioni i themeluar nga kuvendi për hartimin e kësaj rregulloreje i ka përfshirë rekomandimet e cekura nga ministritë gjegjëse.

Ministritë e linjës kanë gjetur se disa nene të kësaj rregulloreje bien ndesh me legjislacionin në fuqi dhe të njëjtat nene komisioni i ka harmonizuar me ligjet pozitive, dhe atë me sa vijon:

Në fushën për gjeodezi dhe kadastër janë marrë për bazë rekomandimet dhe është plotësuar rregullorja me udhëzimet administrative sipas instruksioneve të dhëna nga ministria e linjës si në vijim:

Udhëzim Administrativ MMPH-Nr.12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës

Udhëzim Administrativ MMPH Nr.08/2019 për tarifat e produkteve dhe shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Udhëzim Administrativ Nr.04/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrative MMPH Nr.08/2019 për tarifat e produkteve dhe shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Ndër të tjera gjatë hartimit të kësaj rregulloreje në nenin 16 është lëshuar një gabim në ç' rast ka mbetur e zbrazët rubrika për sa i përket takës lidhur me Vendosja e TS (trafostacionit) në prona publike

Në rastin konkret Drejtoria për Urbanizëm ka propozuar që kjo takës të jetë 200 €

| | | |
|---|---|---|
| 16.6.4 | Vendosja e TS (trafostacionit) në prona publike | |

Lidhur me taksat dhe tarifat në fushën e urbanizmit, sektori i nderimit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, zyrtarja ligjore e kësaj drejtorie ka marrë pëlqimin nga MMPHI-ja pëlqimin paraprak për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Në shtojcë gjeni të bashkëngjitur pëlqimin lidhur me taksat të lëshuar nga MMPHI.

Sa i përket fushës së planifikimit hapësinorë, është marrë për bazë rekomandimi nga MMPHI dhe është shtuar taksa si në vijim:

*Taksa për çdo kopje të dokumenteve të planifikimit hapësinor të komunës të kërkuara nga pala, vlera e taksës 5.00 €.*

Rekomandimi për përcaktimin e lartësisë së qirasë për dhënien në shfrytëzim të ndërtesave në pronësi komunale, për banim social, nga zyrtarët e Drejtorisë së Shëndetësisë, kemi marrë konfirmimin se Komuna e Vushtrrisë nuk ka në disponim ndërtesa në pronësi komunale për banim social.

Për më tepër sqarime të bashkëngjitur si referencë keni raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së kësaj rregulloreje.

**Me respekt!**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë<br>Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së | |
| Nga: | Jeton Qela, U.d.Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | Date:<br>23.10.2023<br>Nr. 43-778 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë<br>2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse | Besim Murtezani, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Gafurr Sllamniku, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Lloji i aktit: | Rregullore e Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregulloren (KKV) Nr. 09/2023 për tarifat, ngarkesa dhe gjoba komunale, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni vlerësimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për aktin në fjalë.

Rregullorja (KKV) Nr.08/2023 për tarifat, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL, Rregulloren KKV) Nr.08/2023 për tarifat, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, datë 28.09.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstaton:

Fusha e ndërtimit

Komuna e Vushtrrisë, me rastin e përcaktimit të taksave administrative për leje ndërtimi, leje rrënimi dhe rritje të densitetit në infrastrukturë, duhet të veproj në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrënimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës dhe dispozitat ligjore që parashihen në Ligjin Nr. 04/L - 110 për Ndërtim, pasi që e njëjta nuk ka bërë kërkesë që nga viti 2019 për pëlqim paraprak të taksave në MMPHI.

Andaj, nëse Komuna e Vushtrrisë, vendos që taksat e njëjta të cilat janë në fuqi t'i zbatojë edhe në vitin vijues (si në rastin konkret siç janë aprovuar edhe në këtë Rregullore), atëherë duhet të dërgoj shkresën njoftuese, në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas shtojcës Nr.10 të Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturë

Fusha e Agjencionit kadastral

Neni 20 paragrafi 1 i Rregullores (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, është i bazuar në Udhezimin Administrativ (2012) i cili është i shfuqizuar, ndërsa dispozitat që përcaktojnë tarifat janë ne pajtim me udhëzimet administrative ne fuqi.

Fusha e Mjedisit

Rregullorja (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Fusha e Banimit

Sipas Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, e veçanërisht në:

- Nenin 9 - Përcaktimi i qirasë, ku ne paragrafin 1 thuhet se "Kuvendi komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës;

- Paragrafi 2 - Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos se administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të objektit të banimit.
- Paragrafi 3- Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës.
- Paragrafi 4 - Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër për qind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër për qind (4 %) e vlerës së banesës në treg.
- Paragrafi 5 - Kur banesat e programeve te veçanta financohen nga burime tjera te përcaktuara me nën-paragrafin 1.3 te nenit 15 dhe me nën-paragrafin 1.3 te nenit 19 të këtij ligji vlera e qerasë e shprehur me Euro/m2, përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve qe financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal, nuk e ka potencuar rregullimin e përcaktimit te qerasë dhe nuk e ka specifikuar.

Rregullorja (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, në asnjë tabelë nuk ka të vendosur Qiranë për dhënie në shfrytëzim te ndërtesat për banim social në pronë Komunale, me sipërfaqe në m²/muaj, e cila duhet të këtë një vlerë financiare të përcaktuar me euro (€), e shprehur në formë tabelore e cila duhet të jetë e përfshirë në rregullore, e përcaktuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe saktësuar lartësinë e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave sociale në pronësi të komunës, nëse komuna e Vushtrrisë ka ndërtesë të banimit social. Por nëse nuk ka asnjë njësi banimi në pronësi komunale, duhet me e deklarua me një koment.

Andaj konsiderojmë se në këtë Rregullore, nuk është specifikuar ky aktivitet sipas formulës së Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e programeve të veçanta të banimit. Rregullorja të rishqyrtohet dhe të plotësohet, për këtë aktivitet të lartcekur duke e respektuar Legjislacionin në fuqi.

Fusha e Planifikimit Hapësinor

Në aspektin e planifikimit, Ligji për Planifikimin Hapësinor i lejon Autoritetit komunal që për çdo kopje të dokumenteve të planifikimit hapësinor të ngarkojë një taksë të kostoš reflektuese.

Neni 22 , LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Kopjet e Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor Autoritetet kompetente komunale ofrojnë kopje të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor për secilin që i kërkon ato. Autoriteti komunal mund të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese për çdo kopje.

From: Merita Dalipi
Sent: Thursday, October 12, 2023 2:11 PM
To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Cc: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>; Ramë Hamzaj <Rame.Hamzaj@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Shendrita Latifi <shendrita.latifi@rks-gov.net>; Adelina Vatovci <Adelina.Vatovci@rks-gov.net>
Subject: RE: Rregullore (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri

Përshëndetje Sabrie,

Përmes kësaj shkrese, ju njoftojmë se sa i përket Rregullores (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, ne përfaqësuesit e Divizionit të Banimit, kemi shqyrtuar këtë dokument dhe vlerësojmë se kjo Rregullore e lartshënuar, sipas Ligji Nr.03/L-164 për Financimin e programeve të veçanta të banimit, e sidomos në:

- Nenin 9 - Përcaktimi i qirasë, ku në paragrafin 1, thuhet se Kuvendi Komunal çdo vit aprovon shumën e qirasë vjetore për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës;
- Paragrafi 2 - Qiraja e grumbulluar nga banesat shfrytëzohet për mbulimin e kostos së administrimit, mirëmbajtjes, amortizimit, riparimet e rregullta dhe investuese të ndërtesës të banimit;
- Paragrafi 3 - Qiramarrësi, përveç qirasë, paguan edhe të gjitha shpenzimet tjera që lidhen me shfrytëzimin e zakonshëm të banesës;
- Paragrafi 4 - Vlera vjetore e qirasë nuk duhet të jetë më e madhe se katër për qind (4%) e kostos së ndërtimit të banesës së shtetit, për ndërtim të ri, apo katër për qind (4 %) e vlerës së banesës në treg;
- Paragrafi 5 - Kur banesat e programeve te veçanta financohen nga burime tjera të përcaktuara në nenit 15, të nën-paragrafin 1.3, dhe në nenit 19, nën-paragrafin 1.3, të këtij ligji vlera e qerasë e shprehur me €/m2, përcaktohet për çdo rast specifik në bashkëpunim në mes subjekteve që financojnë dhe komunës ku zbatohet projekti dhe miratohet me vendim të Kuvendit Komunal, nuk e ka potencuar rregullimin e përcaktimit të qerasë dhe nuk e ka specifikuar.

Mendimi Profesional:

Kjo Rregulloren (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, në asnjë tabelë nuk ka të vendosur Qiranë për dhënie në shfrytëzim te ndërtesat për banim social në pronë Komunale, me sipërfaqe në m²/muaj, e cila duhet të ketë një vlerë financiare të përcaktuar me euro (€), e shprehur në formë tabelore e cila duhet të jetë e përfshirë në rregullore, e përcaktuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe saktësuar lartësinë e qirasë mujore për shfrytëzimin e banesave sociale në pronësi të komunës, nëse komuna e Vushtrrisë ka ndërtesë të banimit social. Por nëse nuk ka asnjë njësi banimi në pronësi komunale, duhet me e deklarua me një koment.

Prandaj konsiderojmë se në këtë Rregullore, nuk e kanë specifikuar këtë aktivitet sipas formulës së Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e programave të veçanta të banimit. Mendojmë se kjo Rregullore të rishqyrtohet dhe të plotësohet, për këtë aktivitet të lartcekur duke e respektuar Legjislacionin në fuqi.

Me respekt

Merita Dalipi
Zyrtare e lartë për banim social, Divizioni i Banimit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ish pallati i mediave "Rilindja" kati 14, nr.1417
10000 Prishtinë/ Republika e Kosovës
e-mail: merita.dalipi@rks-gov.net
http://www.mmphi-rks.org

From: Nadir Shyqeriu
Sent: Thursday, October 12, 2023 2:23 PM
To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>; Bashkim Shaqiri <Bashkim.Shaqiri@rks-gov.net>
Cc: Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>
Subject: Re: Shkresë përcjellëse nga MAPL

E nderuar,

AKK shqyrtoi kërkesën tuaj dhe konstaton se ne Rregulloren (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, tek neni 20 parag. 1, i referohet Udhëzimit Administrativ (2012) i shfuqizuar, ndërsa dispozitat qe përcaktojnë tarifat janë ne pajtim me UA ne fuqi.

Me respekt,

---

From: Sabrie Rama
Sent: Thursday, October 12, 2023 1:28:01 PM
To: Bashkim Shaqiri
Cc: Nadir Shyqeriu; Florije Kika
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

From: Suzana.Goranci
Sent: Thursday, October 12, 2023 9:13 AM
To: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>
Cc: Vjollca Puka <Vjollca.Puka@rks-gov.net>; Burbuqe Hydaverdi <Burbuqe.Hydaverdi@rks-gov.net>; Labinota Jahja <Labinota.Jahja@rks-gov.net>; Lindita Radoniqi <Lindita.Radoniqi@rks-gov.net>; Arberore Veliu <arbenore.veliu@rks-gov.net>; Adelina Vatovci <Adelina.Vatovci@rks-gov.net>; Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

Përshëndetje Drejtor,

Te poshtëshënuar gjeni vlerësimin ne aspektin profesional te shqyrtimit te ligjshmërisë se vendimit

Gjitha te mirat,
Suzana

From: Burbuqe Hydaverdi
Sent: Wednesday, October 11, 2023 3:48 PM
To: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>; Suzana.Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>
Cc: Labinota Jahja <Labinota.Jahja@rks-gov.net>; Lindita Radoniqi <Lindita.Radoniqi@rks-gov.net>; Arberore Veliu <arbenore.veliu@rks-gov.net>; Adelina Vatovci <Adelina.Vatovci@rks-gov.net>
Subject: RE: Shkresë përcjellëse nga MAPL

Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit për Rregulloren (KVV) Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, ju njoftojmë me sa vijon:

Në aspektin e planifikimit, Ligji për Planifikimin Hapësinor i lejon Autoritetit Komunal që për çdo kopje të dokumenteve të planifikimit hapësinor të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese.

Neni 22, LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR
Kopjet e Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor Autoritetet kompetente komunale ofrojnë kopje të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor për secilin që i kërkon ato. Autoriteti komunal mund të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese për çdo kopje.

From: Rizah Muqolli
Sent: Tuesday, October 10, 2023 3:40 PM
To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Cc: Ismail Hetemaj <Ismail.Hetemaj@rks-gov.net>; Visare Hoxha <Visare.Hoxha@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

Pershendetje

Rregullorja per tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale te Komunes se Vushtrrise, eshte ne harmoni me legjislacionin ne fuqi.

From: Fatmir Azemi
Sent: Monday, October 16, 2023 2:51 PM
To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Cc: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>; Suzana.Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>; Ramë Hamzaj <Rame.Hamzaj@rks-gov.net>; Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>; Miradije Gerguri <Miradije.Gerguri@rks-gov.net>; Visare Hoxha <Visare.Hoxha@rks-gov.net>; Ibrahim Balaj <Ibrahim.Balaj@rks-gov.net>; Florije Tahiri <Florije.Tahiri@rks-gov.net>; Rizah Muqolli <Rizah.Muqolli@rks-gov.net>; Nadir Shyqeriu <Nadir.Shyqeriu@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Shendrita Latifi <shendrita.latifi@rks-gov.net>; Bashkim Shaqiri <Bashkim.Shaqiri@rks-gov.net>; Ismail Hetemaj <Ismail.Hetemaj@rks-gov.net>
Subject: RE: Shkresë përcjellëse nga MAPL

E nderuar,

Është shqyrtuar Rregullorja Komunale Nr.08/2023 për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, më datë 28.09.2023 dhe konstatojmë si në vazhdim:
Taksat administrative për leje ndërtimi dhe leje rrënimi të përcaktuara me këtë rregullore, sipas UA Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e Infrastrukturës, duhet të dërgohet shkresa në Ministri (MMPHI), për aprovim, gjë që kjo komunë që nga viti 2019 nuk e ka bërë një kërkesë të tillë.
Nëse Komuna vendos që taksat e njëjta të cilat janë në fuqi t'i zbatojë edhe në vitin vijues (si në rastin konkret siç është aprovuar në Rregullore të kësaj komune), atëherë duhet të dërgon shkresën njoftuese, në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas shtojcës Nr.10 të Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Me nderime,
Fatmir Azemi, DPHNB/DB

**Gafurr Sllamniku**

| | |
|---|---|
| From: | Xhevat Tafa |
| Sent: | Tuesday, October 17, 2023 10:34 AM |
| To: | Gafurr Sllamniku |
| Subject: | FW: Nr.VL-250/23 |
| Attachments: | VL-250-2023 Vushtrri.docx |

From: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Sent: Tuesday, October 17, 2023 10:33 AM
To: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>
Cc: Ardita Latifi <Ardita.Latifi@rks-gov.net>
Subject: Nr.VL-250/23

I nderuar,

Bashkangjitur gjeni vleresimin e ligjshmerise se Rregullores (KKV) Nr.08/2023 për tarifat, ngarkesa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Vushtrri, datë 28.09.2023.

Me respect!

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 08/12/2023 |
| **REFERENC-Ë:** | |
| **PËR/ZA/TO:** | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna Vushtrri |
| **CC:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | Izedin Bytyqi, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Shqyrtimi i shkresës nga Komuna Vushtrrisë me numër të protokollit nr.7081/23 të datës 04/12/2023 |

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 04/12/2023 me numër protokolli 7081/23, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore, taksës administrative për leje rrënimi dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës nga Komuna e Vushtrrisë (tutje si: Komuna), MMPHI ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar taksat në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Bazuar në nenin 22, nën-paragrafi 1.1. të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe nenit 14, paragrafi 1 dhe 2 të UA nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, Komuna ka të drejtë të zbatoj taksat aktuale edhe për vitin pasues, sipas pëlqimit nga ana e MMPH-së me numër protokolli 5976-2/19 të datës 14/10/2019.

Me respekt,

Bastri Duraku

From: Ilirjana Azemi
Sent: Wednesday, October 25, 2023 10:25 AM
To: Bastri Duraku
Cc: Fortuna Krasniqi
Subject: FW: Raporti vlersimit të ligjshmërisë së akteve të KK-vushtrri
Attachments: image003.jpg; 43-778-2-2023.pdf

I nderuar ,

Pas pranimit të këtij emaili lidhur me Raportin e vlersimit të ligjshmerisë për Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, ne pamë se konstatimet e dhëna nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor që kanë të bëjn me fushën e ndertimit , ne kemi vlersuar që edhe për vitin parapark të jenë të nejtat taksa për leje ndertimore, leje rrënimi dhe tarifat e densitetit të cilat komuna I ka të aprovuar pas marrjes së pëlqimit parapark nga MMPHI dhe se për këtë bazuar në Ligjin për Ndertim Nr.04/L-110 si dhe Udhezimin Administartiv 02/2018 për taksat Administartive për Leje Ndërtimore , Leje Rrënimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastruktures, ne menjiher do ta dërgojm shtojcen Nr.10 të Udhezimin Administartiv 02/2018 për taksat Administartive për Leje Ndërtimore , Leje Rrënimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastruktures, për marrjen e pëlqimit parapark në Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures lidhur me taksa të prezantuara si në këtë rregullore, ndërsa lidhur me rekomandimet e dhëna në fushën e banimit kjo fushë është në kompetenc të Drejtorisë për Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale, e cila parashihet me Ligjin Nr.03/L-164 për finacimin e programeve të veçanta të banimit.

Dhe se Fusha e Planifikimit Hapësinor e cila sipas nenit 22 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 ku thuhet se Autoritetet kompetente komunale ofrojnë kopje të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor për secilin që I kërkon ato. Autoriteti komunal mund të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese për çdo kopje, ketë e kemi paraparë në Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale në nenin 16 pika 16.1 e cila nënkupton çështjen në fjalë, si dhe rekomandimet e dhëna se Udhëzimi Administrativ 2012 I cili është I përfshirë në këtë rregullore është jashit skadimit të afatit kjo duhet të sqarohet me Drejtorin për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, pasi që është në kompetenc të tyre.

**Me respekt!**

**Ilirjana Azemi IGRISHTA**

Zyrtare e lartë ligjore
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Komuna Vushtrri
Rr. Isa Boletini Nr. 44, 42000

+386 44 347 419 | tel
ilirjana.azemi@rks-gov.net | e-mail

From: Fortuna Krasniqi
Sent: Monday, October 23, 2023 10:58 PM
To: Ilirjana Azemi <ilirjana.azemi@rks-gov.net>
Subject: Fwd: Raporti vlersimit të ligjshmërisë së akteve të KK-vushtrri

Përshëndetje Ilirjana,

Të lutem shqyrtoje raportin dhe përmirësoje aty ku ka nevojë.

Me respekt,

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

> **From:** Bastri Duraku <bastri.duraku@rks-gov.net>
> **Date:** October 23, 2023 at 16:26:16 GMT+2
> **To:** Fortuna Krasniqi <fortuna.krasniqi@rks-gov.net>, Bekim Selmani <bekim.selmani@rks-gov.net>, Nasuf Aliu <nasuf.aliu@rks-gov.net>
> **Subject:** FW: Raporti vlersimit të ligjshmërisë së akteve të KK-vushtrri
>
> Pëshëndetje i/e nderuar ,
>
> Bashngjitur, gjeni rapotin e vlersimit te rregullores per Tarifa dhe Ngarkesa Komunle qe Ministrtia e Mjedisit ka gjetur se disa nga nenet nuk jane në perputhje me legjislacionin ne fuqi.
>
> **From:** Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>
> **Sent:** Monday, October 23, 2023 3:47 PM
> **To:** Bastri Duraku <bastri.duraku@rks-gov.net>
> **Cc:** Bujar Shatrolli <bujar.shatrolli@rks-gov.net>; Shpetim Zhegrova <shpetim.zhegrova@rks-gov.net>; Albiona Isa <albiona.isa@rks-gov.net>
> **Subject:** FW: Raporti vlersimit të ligjshmërisë së akteve të KK-vushtrri
>
> Me respekt,

---

**Ferit Idrizi**
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë
Komuna Vushtrri
Tel: +383 38 200 42 402
Adresa: Sheshi Ahmet Krasniqi nr 10, 42000, Vushtrri

**From:** Shkrimorja Mapl
**Sent:** Monday, October 23, 2023 3:45 PM
**To:** Ferit Idrizi; Melihate Basholli Latifi; Zyra pritëse
**Cc:** Izedin Bytyqi; Feti Berisha; Nazim Berisha; Besim Murtezani; Xhevat Tafa; Gafurr Sllamniku; Sibel Gutiq
**Subject:** Raporti vlersimit të ligjshmërisë së akteve të KK-vushtrri

**Bastri Duraku**

**From:** Ramiz Maliqi
**Sent:** Tuesday, December 26, 2023 11:44 AM
**To:** Bastri Duraku
**Subject:** Kërkesë

I nderuar,
Po kërkojmë që te vendosja e TS (trafostacionit) në prona publike të jetë 200€/cope.

**Bastri Duraku**

| | |
|---|---|
| From: | Ilmi Zeqiri |
| Sent: | Monday, December 18, 2023 3:12 PM |
| To: | Bastri Duraku |
| Subject: | udhezimet administrative |

Udhezim administrative MMPH-Nr.12/19 per ndarjen dhe regjistrimin e parceles

Udhezim administrative MMPH Nr.08/2019 per tarifat e produkteve dhe sherbimeve te Agjencise Kadastrale te Kosoves.

Udhezim administrative Nr.04/2021 per ndryshimin dhe plotesimin e Udhezimit administrative MMPH Nr.08/2019 per tarifat e produkteve dhe sherbimeve te Agjencise Kadastrale te Kosoves.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 08/12/2023 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna Vushtrri |
| CC: | |
| NGA/OD/FROM: | Izedin Bytyqi, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Shqyrtimi i shkresës nga Komuna Vushtrrisë me numër të protokollit nr.7081/23 të datës 04/12/2023 |

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 04/12/2023 me numër protokolli 7081/23, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore, taksës administrative për leje rrënimi dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës nga Komuna e Vushtrrisë (tutje si: Komuna), MMPHI ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar taksat në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Bazuar në nenin 22, nën-paragrafi 1.1, të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe nenit 14, paragrafi 1 dhe 2 të UA nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, Komuna ka të drejtë të zbatoj taksat aktuale edhe për vitin pasues, sipas pëlqimit nga ana e MMPH-së me numër protokolli 5976-2/19 të datës 14/10/2019.

Me respekt,